



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 400/01-12552/24  
Kaçanik, 31.05.2024

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit Nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 61 të Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008), të nenit 2 të Ligjit Nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare Nr. 27/03 Qershor 2008) si dhe Ligjit për Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/03 Gusht 2016), të nenit 6 të Ligjit 08-L/260 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 26/29 Dhjetor 2023), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 maj 2024, mori këtë

**VENDIM**  
**PËR BARTJEN E TË HYRAVE TË TEJKALUARA**  
**NGA VITI 2023 NE VITIN 2024**

1. Të Hyrat Vetanake (Fondi 21, gjobat e Gjykatave, Policisë dhe AGJPK) të realizuara gjatë vitit 2023 kanë qenë gjithsej 1.092,788.68 euro ndërsa planifikimi vjetorë ka qenë 862,578.00 euro. *Tejkalimi i të hyrave është në shumë prej 230,210.68 euro.*
2. Tejkalimi i të hyrave vetanake komunale te vitit 2023 është realizuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve:
  - 2.1 Kategoria e Investimeve kapitale shuma prej 115,210.68 euro;
  - 2.2 Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve shuma prej 90,000.00 euro dhe
  - 2.3 Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve shuma prej 25,000.00 euro.
3. Destinimi apo kërkesa për bartje te kësaj shume planifikohet te bëhet:
  - 3.1 PB – Zyra e Kryetarit - nënprogrami (16028), shuma prej 90,000.00€ ne kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve;
  - 3.2 PB – Zyra e Kuvendit Komunal - nënprogrami (16928), shuma prej 10,000.00€ ne kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve;
  - 3.3 PB – Administrata e Përgjithshme - nënprogrami (16328), shuma prej 10,000.00€ ne kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve;

- 3.4 PB – Buxhetimi - nënprogrami (17528), shuma prej 5,000.00€ ne kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve dhe shuma prej 110,210.68€ ne kategorinë e Investimeve kapitale në projektin “Mjetet për bashkëfinancim të projekteve” me kod 86245.
- 3.5 PB – Infrastruktura rrugore - nënprogrami (18028), shuma prej 5,000.00€ ne kategorinë e Investimeve kapitale në projektin “Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën Fadil Bunjaku” Biçec – Projekt i ri.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërkaq do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (përmes kësaj drejtorie organet tjera relevante);
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli